



**Informimi javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°2/2022

Hagë, 20/01/2022

Përditësim

Mirë se vini në informimin javor për median të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'ju ofrojmë gazetarëve një përditësim mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë, informacion për javën e ardhshme dhe mundësinë për të drejtuar pyetje.

Gjykimi i Salih Mustafës rifilloi të martën, më 18 janar me dëshminë e dëshmitarit W04485, të thirrur nga Zyra e Prokurorit të Specializuar. Dëshmitari dëshmoi pa masa mbrojtëse. Ai dëshmoi lidhur me Brigadën 153 të UÇK-së, njësitin BIA dhe në përgjithësi për strukturën e UÇK-së në Zonën Operative të Llapit. Dëshmitari përfundoi dëshminë e tij të mërkurën, më 19 janar.

Gjithashtu, gjatë seancës më 19 janar, Kryegjykatësja e Trupit Gjykses i njoftoi se së shpejti Trupi Gjykses do të nxjerrë një vendim në të cilin do të përcaktohen hapat e ardhshëm proceduralë në çështjen *Mustafa*. Këto hapa përfshijnë mbylljen e paraqitjes së provave prej ZPS-së, çka është parashikuar për datën 2 shkurt 2022, si dhe mbajtjen e konferencës për ecurinë e çështjen gjyqësore të planifikuar për datat 17 ose 18 shkurt 2022, ku do të diskutohet faza e ardhshme e gjykimit, me ZPS-në, Mbrojtjen, dhe mbrojtësen e viktimave.

Çështja do të rifillojë më 25 janar në orën 9:30 paradite me dëshmitarin tjetër.

Në çështjen e z. *Gucati dhe z. Haradinaj*, dëshmitari i dytë i thirrur prej Mbrojtjes së Haradinajt përfundoi dëshminë e tij të premten, më 14 janar.

Dëshmitari tjetër në këtë çështje është planifikuar të fillojë dëshminë nesër, më 21 janar. Seanca do të fillojë në orën 9:30 paradite.

Në çështjen *Pjetër Shala*, Mbrojtja dhe Prokuroria në një seancë të procedurës paraprake të premten, më 14 janar, diskutuan aspekte lidhur me procesin e nxjerrjes së materialeve si dhe hapat e mëtejshëm për t'u ndërmarrë në këtë çështje.

Pyetje nga gazetarët

Nuk pati pyetje

